



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 32/15

Prishtinë, më 21.10.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Latif Gashi, Labinot Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave Financave, Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Administratës së Kuvendit, Istret Azemi - Drejtor i Drejtorisë për buxhet dhe pagesa të Administratës së Kuvendit.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Aleksandra Fehlinger dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Sylejman Blakaj- Gazetar nga Kosova Sot, Lumnije Murati - nga Zyra e Presidentes, Besarta Jashari- Gazetar nga RTK, Faton Salihu – Gazetar nga Infodirekt, Amire Qamili – Gazetare, Genc Jaha – monitorues nga KDI, Albulena Mavraj- Gazetare nga Epoka e Re, Resmije Ballahi – Gazetare nga TV Rrokum.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 30.09.2015;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin në Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së tretë të Ministrisë së Financave 2016/03;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014;**
- 7. Shqyrtimi i Propozimeve të Komisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;**
- 8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin nr.04/L-045 për Sigurimet;**
- 9. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 30.09.2015

Kryetari – konstatoi e procesverbalin miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194

Avdullah Hoti - theksoi se plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, është në harmoni me programin e FMN-së që e kemi nënshkruar në muajin korrik. Me ndryshimet e propozuara, heqet kufizimi i rregullës fiskale për investime, respektivisht në mundësinë e hyrjes në kredi ndërkombëtare për të financuar projektet e mëdha të cilat nuk mundemi me i financue me buxhetin që e kemi në dispozicion. Duke u nisur nga fakti që borxhi i Kosovës është ulët, rreth 12%, ne kemi hapësirë të mjaftueshme të hyjmë në kredi ndërkombëtare dhe jemi dakorduar me FMN-në që të mund të hyjmë në kredi për investime kapitale, për aq sa borxhi publik është në nivelin 30% e GDP-së. Por në anën tjetër është kufizuar vlera e disbursimeve vjetore që ne mund të bëjmë që të mos kemi mundësi që menjëherë të hyjmë në borxh të madhë publik, pastaj të rritet bara në buxhetin e Kosovës.

Një ndryshim tjetër esencial i propozuar është kufizimi i fondit të rritjes së pagave me nivelin e zhvillimit ekonomik. Rritja e pagave do të bëhet çdo vit me propozim të Ministrisë së Financave me mundësitë e buxhetit vjetore, respektivisht rritja e pagave do të bazohet në rritjen nominale të GDP-së. Ju e dini se në fillim të këtij viti kemi pasur probleme me buxhetin e disa komunave në veri sepse nuk e kanë aprovuar buxhetin e tyre në përputhje me qarkoret buxhetore. Në muajin mars të këtij viti është dashtë të bllokojmë buxhetin e atyre komunave dhe për shkak të mosefikasitetit të kryetarëve të komunave dhe asambleve komunale, punëtorët nuk kanë marrë rroga. Me ndryshimet në këtë projektligj, ne e kemi mundësuar që pagat e shërbyesve civil në arsim e shëndetësi të mos ndërprehen edhe në situata kur komuna nuk e ka miratuar buxhetin me kohë në pajtim me kufijtë e përcaktuar në qarkoren buxhetore.

Të tjerat ndryshime kanë të bëjnë me një funksionim pak më të mirë të strukturës së departamenteve të buxhetit në Ministrinë e Financave që të bëjmë një departament të buxhetit të përgjithshëm dhe dy divizione për buxhetin qendror dhe lokal. Sa i përket ndryshimeve për Thesarin, kompetencat mbeten të pandryshuara, por planifikojnë një riorganizim më të mirë të auditorit, personelit, në mënyrë që ti unifikojmë brenda ministrisë.

Naser Osmani – ne kemi thënë se Ligji për Menaxhimin e Financave Publike është kushtetutë për financat publike dhe prandaj çdo ndryshim që bëhet duhet arsyetuar mirë. Në nenin 4 ku janë propozuar ndryshimet është thënë se Thesari të jetë në përputhje me politikat e ministrisë, pse nuk duhet të jetë në pajtim me ligjin e menaxhimit të financave publike dhe konsiderojë që duhet shikuar mirë këtë qështje në mënyrë që thesari të ketë pavarësinë në punë në pajtim me ligjin. Çështja tjetër ka të bëjë me nenin 5, ku po ndodh ndajra në dy divizione, një divizion i buxhetit qendror dhe një tjetër për buxhetin komunal, ku ishte dashtë të jetë një drejtori e përgjithshme. Te qështja e rregullës fiskale të cilën e kemi diskutuar shumë edhe me juve edhe me FMN-në, ne jemi pajtuar që të bëhet ndryshim i rregullës fiskale për shkak se kemi nevojë për mjete investive dhe me këto propozime tashmë është menduar që mos të ketë kufizime në huazimet e jashtme për projektet kapitale, por qfarë ndodh me huazimet e brendshme, a vlejnë për këto rregulla fiskale? Duhet pasur parasysh edhe faktin se rritja e investimeve kapitale rritë nevojën edhe për shpenzime rrjedhëse. Te qështja e pagave, është mirë po vëjmë një rregull në paga që ajo të bëhet me rritjen e BPV dhe që konsiderojë se është një zgjidhje e mirë. Por pyetja që shtorhet është se a duhet të merret parasysh edhe rritja inflacionit në këtë drejtim? Çështja tjetër ka të bëjë propozimin kur komuna nuk e cakton me

kohë buxhetin, ministria e financave e cakton një administrator që merr kompetencat e kryetarit. Kur është fjala për kompetencat e kryetarit është pak e ndishme, sepse kryetari menaxhon buxhetin me prioritetet e investimeve që i ka planifikuar dhe pyetja është si mundet administratori me e bind asambleistat komunal me e votue buxhetin, kur kryetari nuk mundet me bë një gjë të këtillë? Një qështje tjetër ka të bëjë me Projektligjin që ka propozuar nisma qytetare, përmes peticioneve, që ka të bëjë me njohjen e kompenzimit jo material, që kemi menduar se do të rregullohet me këtë projektligj dhe ju nuk e keni trajtuar këtë qështje, dhe ne tani na duhet me procedue edhe me atë ligj ndaras.

Avdullah Hoti - tek nenin 4 që i cakton përgjegjësitë e drejtorit të thesarit, ne nuk kemi asnjë problem dhe pajtohem plotësisht që ky nen të fshihet. Tek neni 5 ndoshta nuk isha i qartë, por momentalisht janë dy departamente: departamenti i buxhetit qendror dhe i buxhetit komunal, dhe propozimi është që të bëhet një departament me dy divizione brenda. Te klauzola e investimeve kemi krijuar një hapësirë të hyjmë në kredi ndërkombëtare financiare me kushte të volitshme me afat kthimi 30 vjeçar, por ne vazhdojmë të huazojm nga tregu vendor apo në tregun e letrave me vlerë.

Sa i përket pagave ajo është e kushtëzuar me rritjen e GDP-së nominale, që në vete përfshin rritje reale ekonomike dhe rritjen e inflacionit. Ajo që jemi marrë vesh edhe me FMN-në dhe që është shkruar edhe në këtë nen, të kujdesemi për rritjen vjetore të fakturës totale të pagave dhe mëditjeve në buxhet, por ne kemi diskrecion të plotë të rrisim pagat sa herë të shohim të nevojshme, por rritja vjetore e fondit total për paga të mos jetë më e madhe se rritja nominale e GDP-së.

Te qështje e bartjes së kompetencave të kryetarit të komunës në administratorine e caktuar nga Ministria e Financave, ka të bëjë me rastin kur kuvendi komunal nuk miraton buxhetin deri me 1 mars të vitit vijues. Qëllimi ka qenë që mos të bllokohet puna dhe të bëhen pagesat për amdinistratë, arsim, shëndetësi, deri në miratimin e buxhetit nga kuvendi komunal. Aktualisht siç është baza ligjore, nuk mund të bëhet asnjë shpenzim në rast se kuvendi komunal, nuk e miraton buxhetin deri me 1 mars.

Kryetari – për sqarim duhet të thënë se rregulla fiskale prej 2% edhe më tutje do të mbetet, por ky kufizim nuk do të vlejë vetëm për mjetet kreditues të jashtme që huazohen për investime kapitale.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin në Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194.

4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015

Ismet Krasniqi – sqaroi se për gjashtëmujorin e këtij viti, shpenzimet për paga dhe mëditje janë realizuar 93.90%, për mallra e shërbime 48.97%, për shpenzimet komunale janë 88.23%, subvencionet e transferet 92.33%, ndërsa investimet kapitale 6.41%.

Besa Gaxherri – unë e kam analizuar me kujdes raportin dhe në krahasimet që keni bërë në mes gjashtëmujorit të vitit 2014 dhe këtij viti, shohim një ndryshim të shpenzimeve prej 650,000 euro. Pse një ndryshim kaq i madh në mes të këtij viti dhe vitit të kaluar në periudhën gjashtëmujore?

Ismet Krasniqi – sqaroi se vitin e kaluar, Kuvendi nuk ka punuar prej 9 majit deri në dhjetor 2014 dhe kjo ka ndikuar në mosshfrytëzimin e mjeteve apo kursimin e buxhetit, siç janë kompenzimet për mungesës seancash. Sa i përket nivelit të shpenzimeve kapitale në gjashtëmujorin e parë është një problem konstant

që po i përcjelle të gjitha organizatat buxhetore e që për shkak të procedruave dhe afateve të prokurimit. Por kjo shifër e shpenzimeve kapitale tashmë është rritur, pasi që jemi në fazën e përfundimit të renovimit të aneksit.

Besa Gaxherri – ekzistojnë dallime të shpenzimeve në mes komisioneve parlamentare. Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk ka bërë asnjë shpenzim edhe përkudër angazhimeve më të mëdha që ka.

Ismet Krasniqi - komisionet parlamentare e kanë buxhetin e ndarë, në kuadër të kësaj, komisionet e përhershme i kanë në dispozicion 10,000 euro, ndërsa komisionet funksional 5,000 euro brenda vitit. Komisionet janë autonome në shpenzimin e buxhetit të tyre.

Besa Gaxherri – një qështje tjetër ka të bëjë me shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, më konkretisht janë shpenzuar 6679 euro për bileta dhe nuk dihet për kanë janë. Po ashtu kemi shpenzime tjera për bileta që janë pa emër dhe në total dalin se janë mbi 10,000 euro ku nuk dihet kush i ka shpenzuar. Sa i përket shpenzimeve për udhëtimin në Panama, shpenzimet për stafin janë përfshirë tek shpenzimet e deputetëve. Pse stafi mbështetës politik hynë tek deputetët? Duhet të jenë të ndarë shpenzimet e administratës prej deputetëve, që të dihet kush po udhëton. Sa i përket shpenzimeve për subvencione, figuron një shumë e shpenzuar prej 6,500 euro, si dhe për një libër të autorit Bardhyl Mahmuti për 280 kopje, janë shpenzuar 8,400 euro, një sqarim për këtë?

Bardhyl Meta – pyeti për mos paisjen e deputetëve me laptop deri më tani? Sa i përket shpenzimeve për subvencione, a është formuar ndonjë komisioni apo si është vendosur me u ble libri i Bardhyl Mahmutit e jo i ndonjë autori tjetër, psh. i Veton Surroit, Jusuf Buxhovit?

Ismet Krasniqi - sa i përket blerjes së lloptopëve dy herë tenderi është anuluar, për shkak se malli nuk i ka plotësuar standardet që i kemi kërkuar. Shpresojmë se herën e tretë do të ketë oferta me standardet e kërkuara dhe lloptopët për deputetë të blihen deri në fund të vitit. Buxheti për subvencione dhe transfere është pjesë e punës së politikës.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomadohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

5. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së tretë të Ministrisë së Financave 2016/03

Ismet Krasniqi – qarkoren e ministrisë kemi problem sepse Qeveria na ka vënë limitet që ne i kemi kërkuar. Është një paisje e nevojshme për Kuendin, që është skeneri.

Kryetari - une konsidurojë se tashmë është vonë të shqyrtohen kërkesat buxhetore që lidhen me qarkoren e tretë, pasi që tashë buxheti shumë shpejtë do të vie në Kuvend dhe atëherë është koha ti diskutojmë kërkesat buxhetore.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni nuk i shqyrtoi kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së tretë të Ministrisë së Financave 2016/03, për shkak të afateve të vonuara dhe të njëjtat do të trajtohen gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit 2016.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Kryetari – në mbledhjen e fundit, kur e kemi shqyrtuar raportin vjetor financiar të ZAP-së, kemi kërkuar sqarime shtesë, këto të dhëna janë ofruar dhe tani është qështje formale e votimit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

7. Shqyrtimi i Propozimeve të Komisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetari – theksoi se Komisioni për Përzgjedhjen e anëtarëve të Fondit Pensional, ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së dhe kandidatët që i kanë plotësuar kushtet formale ligjore i janë dërguara Kuvendit për emërim. Kandidatët e propozuar janë emra të njohur dhe profesionist të fushës. Kështu që unë mendojë që si komision ti rekomandojmë Kuvendit për emërimin e tyre, që duhet të bëhet në paketë pasi që nuk ka kundër kandidatë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit, të emëroj kandidatët e propozuar nga Komisioni për Përzgjedhje, për kryesues dhe anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, si në vijim:

1. Ymer Havolli, Kryesues

2. Frederick Artesani, anëtar

3. Behxhet Haliti, anëtar

4. Joly Dixon, anëtar

5. Ruzhdi Morina (anëtar për përfaqësimin dhe këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre).

2. Mandati i kryesuesit dhe anëtarëve të emëruar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, është tre vjeçar, në pajtim me nenin 4.6. të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.

8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin nr.04/L-045 për Sigurimet

Kryetari – Grupi Punues ka mbajtur disa takime dhe ka shqyrtuar Projektligjin për Sigurimet, në të cilat takime kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe BQK-së, janë bërë rregullimet e nevojshme dhe kemi të bëjmë me një ligj të rëndësishëm që janë marrë parasysh edhe direktivat e BE-së në këtë fushë dhe në fund kemi propozuar disa amendamentet që e bëjnë një ligj më të mirë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

Komisioni miratoi të gjitha amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për Projekligjin nr.04/L-045 për Sigurimet dhe Raporti me amendamente procedohet për vlerësim në komisionet tjera të përhershme.

9. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi se lidhur me sistemin e raportimit, ashtu siç jemi marrë vesh, me mbështetjen e GIZ-it, ne kemi përgaditur letrën njoftuese që do t'iu dërgohet ministrave përkatës për t'i njoftuar me këtë proces, ministrat të financave dhe juve si deputet raportues do t'iu dërgohen këto letra për njoftim. I falenderojë të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë proces, në veçanti znj. Emma Kelner nga Gjermani për profesionalizimin që ka dhënë. Është një metodë e mirë e punës së komisioneve, që ndoshta do të ishte mirë të diskutohet me kryetarin e kuvendit që edhe komisionet tjera të implemetojnë një ndarje të tillë të punës.

Mbledhja përfundoi në ora 12:03

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani